

AKT THEMELIMI

Shoqëria “PROTHERM EPS” sh.p.k

Sot më datë 09/06/2023, une i nënshkruari z. **Laert Qëndro** shtetas shqiptar, i datelindjes 17/06/1979, banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit nr H90617169J dhe une i nënshkruari z. **Altin Guga** shtetas shqiptar, i datelindjes 04/07/1973, banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit nr H30704044T shprehim vullnetin tone për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “PROTHERM EPS” sh.p.k si më poshtë vijon:

1. FORMA LIGJORE

“PROTHERM EPS” sh.p.k është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar.

2. ORTAKET THEMELUES

Ortaket themelues te shoqërisë janë Laert Qëndro dhe Altin Guga.

3. OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “PROTHERM EPS” sh.p.k. është “Prodhim dhe shitje poliesteroli, materiale ndertimi, inerte, etj”

4. SELIA

Selia e shoqërisë tregtare “PROTHERM EPS” sh.p.k është në adresën: Tirane, Peze, PEZE HELMES, Lagjja Pezë Helmës, Rruga Nacionale Tiranë - Durrës, Kapanon 1 Katësh në Zonën Kadastrale Nr.2953, Nr.i Pasurisë 116/3, 116/1 .

Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:

Prothermbyprodekor@gmail.com

Shoqëria ka të drejtë të hapë degë dhe të zhvillojë veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. KOHËZGJATJA

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të pacaktuar, e cila fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

Afati i përmendur në paragrafin 1, te këtij neni mund të shkurtohet me vendim të Asamblese se Ortakeve të shoqërisë, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Statuti i shoqërisë.

6. KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare "PROTHERM EPS" sh.p.k. është 100.000 (Njëqind mije) leke i perfaqesuar nga 2 kuota , vlera nominale e te cilave eshte 50.000 (pesedhjete mije) leke dhe 50.000 (pesedhjete mije) leke.

Ortaket jane zoterues te kuotes qe perfaqesojne 100 % te kapitalit te shoqerise .
Kuotat jane nominative dhe nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë.
Kuotat përfaqëson të drejtën e një votë.

7. ORTAKET

Ortaket i ushtrojne kompetencat që ligji i jep Asamblesë së Ortakeve.

8. DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI


- Shoqëria drejtohet nga 1(nje) Administrator.
- Administratori i shoqërisë "PROTHERM EPS" sh.p.k do te jete z. **Altin Guga** Administratori emërohet me Vendim të Asamblese se Ortakeve, për një periudhë jo më shumë se 5 (pese) vjet me te drejte ripërtëritjeje.
- Përfaqësimi i shoqërisë tregtare "PROTHERM EPS" sh.p.k në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njeh ligji dhe statuti, i përket administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkoje për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

9. SHPËRBËRJA DHE LIKUIDIMI

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkakut ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

THEMELUESIT

Laert Qëndro



Altin Guga

ALTIN GUGA

